

# PYETJE: «NË QOFTË SE BIBLA ËSHTË FJALA E PERËNDISË, ATËHERË PSE PËRPIQEN NJERËZIT TA INTERPRETOJNË SIPAS SHIJEVE DHE INTERESAVE TË TYRE?»

**PËRGJIGJE:** Një prej parimeve kryesore të Lëvizjes Reformuese (lëvizje e shekullit të 15–16 A.D. në fushën e fesë) ishte se «feja e vërtetë gjendet në Shkrimet (Biblën)» dhe «çdo pikëpamje që ka lidhje me kristianizmin, por që nuk gjendet në Bibël nuk duhet pranuar, sepse është e pavërtetë».

Të gjitha kishat e ndryshme që ekzistojnë sot pretendojnë se ndjekin të njëjtin libër (Biblën), ndërkohë që ato të gjitha ndjekin doktrina<sup>1</sup> të ndryshme nga njëra-tjetra!

Çfarë nuk shkon me këtë? Pse njerëzit e interpretojnë Biblën në mënyra të ndryshme, nëse ajo përfaqëson të njëjtin mesazh që Perëndia u ka dhënë të gjithë njerëzve? Ku e gjejnë njerëzit autoritetin që, në mënyrë të vetëdijshme, të shtrembërojnë Fjalën e Perëndisë me anë të interpretimeve të tyre? Meqenëse këto kisha të ndryshme janë krijuar nga e njëjta Bibël, është e qartë që ekziston një problem në komunikim. Kjo mënyrë komunikimi ngjason me një komandant ushtrie që u jep urdhër ushtarëve të tij të marshojnë drejt armikut. Ata e dëgjojnë urdhërin, ndahen në njëqind kompani të ndryshme dhe fillojnë të luftojnë, jo armikun, por njëri-tjetrin! Në të njëjtën mënyrë, Perëndia na ka dhënë Fjalën e Tij dhe ne, njerëzit, pasi e studiojmë atë Fjalë, ndahemi në njëqind formacione luftimi dhe luftojmë, jo armikun, por njëri-tjetrin! Diçka nuk shkon këtu!

Çfarë nuk shkon? Kjo është një pyetje që do përgjigje.

## KUSH E KA FAJIN?

Në fillim, le të pyesim veten, Kush e ka fajin?

Çdo lloj komunikimi përfshin tre elementë: burimin e mesazhit, mesazhin dhe marrësin e mesazhit. Në qoftë se ju doni të komunikoni me një mikun tuaj duke i shkruar një letër, atëherë ju jeni burimi i komunikimit në këtë rast. Përmbajtja e letrës është mesazhi që do të komunikohet dhe miku juaj është marrësi në këtë proces komunikimi. Në të njëjtën mënyrë, çdo fjalim ka një folës (burimi), një përmbajtje (mesazhi) dhe dëgjues (marrësit). Në rastin e Biblës, këto tre elementë janë gjithashtu të pranishëm. Shikoni 2 Timoteut 3:16, 17: «I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqe dhe për edukim me drejtësi, që njeriu i Perëndisë të jetë i përkryer, tërësisht i pajisur për çdo vepër të mirë.» Perëndia (burimi) u dha Shkrimet apo Biblën (mesazhin) njerëzve të Tij (marrësit). Kështu, në qoftë se ka ndonjë ndërprerje në komunikimin midis Perëndisë dhe njeriut, problemi duhet në jetë në një nga këta tre elementë: Ndërprerja në komunikim është ose faji i Perëndisë, ose faji i mesazhit, ose faji i njerëzimit. Kush e ka fajin?

## Faji i Perëndisë?

A është faji i Perëndisë që ne nuk e kuptojmë Librin e Tij të gjithë në të njëjtën mënyrë dhe, si rrjedhim, ndahemi në kisha të ndryshme?

A ishte mesazhi që u dërgoi Perëndia njerëzve

i ndërtuar në formën e gjëegjzave? Njerëzit paganë të kohëve të lashta mendonin se zotat e tyre flisnin në këtë mënyrë që ta vështirësonin me qëllim mesazhin e tyre. Disa herë njerëzit duke besuar sinqerisht në këto të ashtuquajtura mesazhe përfunduan në shkatërrim.

A është i tillë Perëndia ynë? A i provokon Ai njerëzit duke u dhënë një mesazh që mund t'i shkatërrojë po ashtu siç mund t'i shpëtojë? A është Bibla një gjëegjzë apo një grup gjëegjzash? Jo! Dikush shkroi:

Bibla nuk është gjëegjzë e Perëndisë për njerëzimin, edhe pse disa njerëz veprojnë sikur të ishte e tillë. Ata gërmojnë dhe kërkojnë, eksplorojnë dhe spekullojnë, ata përdorin lloj-lloj mënyrash, ata mbledhin dhe pjestojnë numra, i shumëzojnë dhe i zbresin ata. Dhe, më në fund, përfundojnë me «interpretime» nga më fantastiket që mund t'u bëhen ndonjëherë pjesëve të veçanta të Biblës.

Bibla nuk është një enigmë, ajo nuk është gjëegjzë, nuk është e mbushur me kuptime të fshehura dhe të papritura, ajo nuk është një labirint.

Perëndia nuk komunikon me ne me gjëegjzë, sepse Ai është Perëndia i drejtësisë dhe kërkon që ne ta kuptojmë Biblën. Ne duhet ta njohim të vërtetën për të shpëtuar (Gjoni 8:32). Ne do të gjykojemi nga Fjala (Gjoni 12:48). Nuk do të ishte e drejtë nga ana e Perëndisë që të na jepte një gjëegjzë, gati të pamundur për t'u zgjidhur, dhe, në fund, të na gjykonte në bazë saktësisë së përgjigjes që ne do t'i jepnim asaj gjëegjzë.

Akoma më shumë, Perëndia nuk na flet me gjëegjzë, sepse Ai është Perëndia i dashurisë. Imagjinoni një njeri që po mbytet dhe nuk është në gjendje të shpëtojë veten. Dikush që ndodhet në breg dhe mund ta shpëtojë atë thërret: «Do të shpëtojë vetëm në qoftë se e zgjidh këtë gjëegjzë!» Ne jemi të humbur, të pa shpresë dhe pa ndihmë! A do të kërkojë Perëndia që ne të zgjidhim gjëegjzën përpara se të na shpëtojë? Perëndia ynë nuk është i tillë!

Në një farë mënyre ne mund të mendojmë se faji është i Perëndisë, sepse duke qenë se Ai është një genie shumë më e lartë se njeriu, çfarë Ai thotë është shumë larg aftësive njerëzore për t'u kuptuar. Kjo tingëllon më e besueshme. Në fund të fundit, mendimet dhe rrugët e Perëndisë janë shumë më të larta se mendimet e njeriut (shiko Isaia 55:8, 9).

Të thuash se mendimet e Perëndisë janë aq më të larta krahasuar me mendimet e njeriut sa që Ai

nuk mund t'i shprehë ato mendime në një mënyrë të tillë që njerëzit të mund t'i kuptojnë, ky nuk është një kompliment që ne i bëjmë Perëndisë. Shpesh kur ne themi për një folës: «Çfarë folësi i mrekullueshëm! Ai është i sofistikuar!» ne nënkuptojmë: «Ai foli mirë, por s'munda ta kuptoja atë që tha!» Kur themi këtë, ne *nuk* i kemi bërë kompliment folësit. Një orator që nuk mund të flasë përpara njerëzve në mënyrë të kuptueshme nuk është një komunikues i mirë! Sidoqoftë disa oratorë janë të aftë të flasin për tema shumë të komplikuar në një mënyrë që edhe njeriu i zakonshëm mund të kuptojë se për çfarë bëhet fjalë. A është Perëndia më pak i aftë se këta të fundit?

Mendoni në këtë mënyrë: Folësi, për të bërë të kuptueshme një temë të vështirë duhet të ketë shumë njohuri rreth saj. Ai gjithashtu duhet të njohë dëgjuesit e tij dhe të dijë si të komunikojë. Perëndia natyrisht e njeh mesazhin e Tij për njerëzit. Ai i njeh shumë mirë dëgjuesit e Tij, sepse Ai vetë i krijoi ata. Dhe Ai di si të komunikojë, sepse Vetë u dha formë rregullave të komunikimit. Sigurisht që Perëndia mund të rregullojë mendimet e Tij në mënyrë që ato t'u përshtaten aftësisë që njerëzit kanë për të kuptuar si edhe nevojave të tyre!

Në qoftë se themi se Perëndia nuk mund të flasë në mënyrë të kuptueshme për njeriun *ne, në të njëjtën kohë, themi se Perëndia dëshiron të bëjë diçka, por s'mundet!* Komunikimi me njeriun nuk është i pamundur për Perëndinë! Perëndisë nuk i mungon as dëshira dhe as aftësia që të komunikojë në mënyrë të kuptueshme me ne. Si rrjedhim, ndërprerja e komunikimit midis Perëndisë dhe njeriut *nuk* është faji i Perëndisë!

### **Faji i Biblës?**

A është faji i Biblës? A është shkruar Bibla në mënyrë të tillë që ne e kemi të pamundur ta kuptojmë atë?

A është gjuha njerëzore, në të cilën Bibla është shkruar, e pamjaftueshme për të shprehur të vërtetën e Perëndisë? A nuk ka fjalë të mjaftueshme për të shprehur të vërtetat që Perëndia dëshiron të komunikojë? Në qoftë se kjo është e vërtetë, atëherë feja është subjekti i vetëm për të cilin gjuha njerëzore është e pamjaftueshme. Gjithë të vërtetat e të gjitha kohërave, të vërtetat e historisë, shkencës, elektronikës, etj. janë shprehur dhe shpërndarë me anë të gjuhës njerëzore. Në qoftë se gjuha njerëzore është

e mjaftueshme për të bërë të mundur komunikimin që çoi njeriun në hënë, atëhere pse duhet të jetë e pamjaftueshme për të ndihmuar njeriun që të shkojë në qiell?

Perëndia përdori fjalën kur i bëri të njohur vullnetin e Tij njeriut. Pali tha: «... por jo me fjalë të mësuara nga dituria njerëzore, por të mësuara nga Fryma e Shenjtë» (1 Korintasve 2:13). Perëndia ia bëri të njohur vullnetin e Tij njeriut me anë të *fjalëve* të frymëzuara. Në qoftë se fjalët ishin të pamjaftueshme për të bërë të ditur mesazhin e Perëndisë, atëherë Perëndia nuk e dinte se çfarë po bënte. Vetë fakti se Perëndia përdori fjalë tregon se fjalët janë të mjaftueshme për të komunikuar Mesazhin.

A është gjuha njerëzore aq e paqartë sa vetë njerëzit s'mund ta kuptojmë atë? Në qoftë se do të ishte e tillë, çdo varg i Biblës mund të nënkuptonte gjëra nga më të ndryshmet dhe asnjë s'mund të dinte me siguri kuptimin e tyre të vërtetë. Në çështjet që kanë të bëjnë me faktet, ekziston shumë pak mosmarrëveshje. Për shembull, kush është Presidenti i Shqipërisë sot? Si e dini? Sepse ju keni marrë informacion për këtë me anë të gjuhës njerëzore. Pra, gjuha nuk është aq e paqartë sa që njerëzit të ndihen aq të pasigurtë sa të shikojnë çdo gjë të komunikuar përmes saj me dyshim apo të mos e pranojnë fare.

Bibla është e shumë e qartë në shumë tema, si për shembull, në temën e ringjalljes. Është e pamundur që duke lexuar Biblën, *nga gjuha e saj*, të kuptosh ndonjë gjë tjetër përveç asaj që Jezusi u ngrit nga vdekja.

Problemi që nuk e kuptojmë Biblën njësoj nuk vjen nga fakti se gjuha është e pakuptueshme, por nga fakti se ne nuk e studiojmë Biblën ashtu siç studiojmë çdo libër tjetër. Imagjinoni po të flasim në këtë mënyrë për një libër historie: Në librat e historisë lexojmë se Ismail Qemali ishte ai që ngriti flamurin në Vlorë duke shpallur në këtë mënyrë pavarësinë e Shqipërisë nga Perandoria Otomane. Dhe të gjithë, pa e vënë në dyshim, e besojmë këtë fakt. Ne nuk themi: «Unë jam i bindur se ishte Luigj Gurakuqi ai që e ngriti flamurin, e jo Ismail Qemali.» Ne nuk e lexojmë historinë në këtë mënyrë dhe as Biblën nuk duhet ta lexojmë në këtë mënyrë. Fjalët s'mund të kenë më shumë se një kuptim në të njëjtën kohë. Kur lexojmë Biblën, nuk është paqartësia e gjuhës që na ngatërron. Por në fakt,

problemi i paqartësisë vjen nga ne vetë. Ne arrijmë në përfundimin se faji për mangësitë e komunikimit midis Perëndisë dhe njeriut nuk është i Biblës.

### **Faji i njeriut?**

A është faji i njeriut në qoftë se Bibla nuk kuptohet njëlloj nga të gjithë njerëzit? Meqenëse për interpretimet e ndryshme të Biblës faji nuk është i Perëndisë apo i Biblës, ato duhet të vijnë nga njeriu: ai është fajtori. Njerëzit e keqinterpretojnë Biblën. Si rredhim, ata i *keqkuptojnë* Shkrimet e Biblës dhe i *keqpërdorin* ato. Kështu ata nuk i binden vullnetit të Perëndisë.

Individë të ndryshëm pyesin: «Pse nuk e kuptojnë njerëzit Biblën njësoj?» Një përgjigje është kjo: «Sepse ata nuk e kuptojnë Biblën dhe pikë.» Ata mund ta *keqkuptojnë* Biblën, por në qoftë se njerëz të ndryshëm arrijnë në përfundime kontraktore gjatë studimit të Biblës, atëherë është e qartë se disa prej tyre nuk e kuptojnë fare mesazhin e Biblës.

### **PSE NJERËZIT E KEQINTERPRETOJNË BIBLËN?**

Kjo na bën të pyesim: «Pse shumë njerëz e keqinterpretojnë Biblën?» Ka shumë përgjigje të mundshme.

*Disa nuk e studiojnë Biblën.* Biblat e këtyre njerëzve janë në raftet e mbuluara nga pluhuri. Kur disa thonë: «Unë nuk e kuptoj Biblën si ju», ata nuk e kuptojnë, sepse ata kurrë nuk e kanë studjuar atë. Në një film vizatimor, njeri prej personazheve tha: «Unë e mendoja veten time si një ekspert për Librin e Zbulesës (libri i fundit i Biblës), deri në momentin kur takova dikë që e kishte lexuar librin e Zbulesës.» Ti nuk mund të pretendosh se e kupton Biblën ashtu siç duhet pa e studiuar atë me shumë vëmendje! (Shiko Mateu 5:6; 2 Timoteut 2:15; 1 Pjetritt 2:2.)

*Disa nuk e pranojnë Biblën si tërësisht të vërtetë.* Ata pranojnë se Bibla mund të përmbajë disa të vërteta, por ata nuk besojnë se ajo është e gjitha e vërtetë. Ata besojnë se Bibla është e vërteta e përzier me të pavërtetën, fakte historike të përziera me folklor. Si mund ta interpretojnë Biblën, kur në të njëjtën kohë ata thonë se Bibla nuk është e vërtetë në gjithçka që thotë? Për të kuptuar Biblën, ju duhet të keni një qëndrim të duhur ndaj Shkrimeve: Ju duhet ta pranoni Biblën si Fjalën e Perëndisë (1 Thesalonikasve 2:13) dhe ta doni atë (2 Thesa-

Ionikasve 2:8–11).

*Disa vetë pajtohen me interpretimet e gabuara të Biblës për të mos humbur privilegjet apo përfitimet që kanë apo thjesht për t'iu shmangur përgjegjësi që vijnë nga pranimi i së vërtetës. Këta njerëz e pranojnë Biblën vetëm përderisa ajo përshtatet me besimin e grupit të tyre fetar ose kur ajo nuk çënon interesat e tyre personale.*

Herë pas here, njerëzit zbulojnë të vërtetën që gjendet në Bibël dhe shkojnë te predikuesit e tyre dhe i pyesin: «Po për këtë?» Ata çuditën që predikuesi nuk është dakord me atë që ata kanë mësuar. Po pse duhet të jenë të çuditur? A nuk ka predikuesi i kishës një interes «jetik» për të besuar atë çfarë predikon grupi fetar të cilit ai i përket? Në fund të fundit, jetesa dhe paga e tij varen nga kjo! Pse duhet që ai të bjerë dakord me një doktrinë tjetër dhe të rrezikojë mirëqenien e tij?!

Ne të gjithë kemi një interes të ngushtë në atë që tashmë besojmë. Ne nuk do të preferonim të ndryshonim besimet tona. Kjo do të bënte të humbnim diçka nga jeta jonë e përditshme. Mirëpo nëse frika për të ndryshuar bindjet tona na frenon t'i ndryshojmë këto bindje, ne kurrë nuk do të jemi të aftë të mësojmë të vërtetat rreth Perëndisë që gjenden në Bibël. Si rrjedhim, çfarë nevojitet për të kuptuar Biblën ashtu siç duhet? Një zemër e ndershme (Luka 8:15). Në qoftë se ju keni një zemër të ndershme, ju do të jeni gati të dorëzoni çdo gjë, s'ka rëndësi se sa e mirë, sa e dobishme apo sa e rehatshme është ajo, për të mësuar të vërtetën!

*Disa e shikojnë Biblën me paragjykime. Është sikur ata të kishin syze të ngjyrosura. Shikoje botën me syze të kuqe dhe gjithë bota do të të duket e kuqe, përmes syzeve blu gjithë bota do të duket blu. Njerëzit bëjnë të njëjtën gjë me Biblën. Ata e hapin Biblën për të gjetur aprovim për bindjet që ata tashmë i kanë. Po ta lexojmë Biblën në këtë mënyrë, ne mund të gjejmë në të mbështetje për çdo lloj bindje tonën, por kështu ne abuzojmë me Fjalën e Perëndisë.*

Të njëjtën gjë bënë hebrenjtë dhe ata nuk e njohën Krishtin kur Ai erdhi. Ata kishin lexuar për Të në Shkrimet e shenjta, por ata donin një Krisht që t'u përshtatej interesave të tyre, jo atë Krisht që Perëndia kishte paracaktuar për shpëtimin e tyre dhe të njerëzimit. Jezu Krishti që erdhi në tokë nuk i përshtatej besimit të tyre të paracaktuar, kështu ata e kryqëzuan Atë. Në një diskutim rreth Mateut

16:18 ku Jezusi tha: «Mbi këtë shkëmb do të ndërtoj kishën Time», unë po përpiqesha t'i shpjegoja bashkëbiseduesit tim se Bibla nuk përmend idenë e një peshkopi të përgjithshëm që qëndron me autoritet mbi Kishën. Përgjigjja e tij ishte: «Por kur e lexoj këtë pjesë me besimin tim, unë shikoj në të një peshkop të përgjithshëm.»

Problemi është se ne të gjithë kemi tendencë që ta lexojmë Biblën sipas shijeve dhe bindjeve tona dhe, si rrjedhim, të shikojmë atje *vetëm* atë që duam të shikojmë. Për çfarë kemi nevojë? Për një mendje të hapur dhe të bëjmë ashtu si bënë Bereasit, të cilët kërkuan Shkrimet për të parë nëse ajo që Pali u mësoi ishte e drejtë apo jo (Veprat 17:11). Për të kuptuar Biblën ashtu siç duhet, studjojeni atë pa paragjykime, për të zbuluar në qoftë se ajo që ju është mësuar është e vërteta apo jo.

*Disa i ndryshojnë Shkrimet për të justifikuar opinionet e tyre. Pjetri tha se janë disa gjëra në letrat e Palit të cilat «të paditurit dhe të paqëndrueshmit i shtrembërojnë, sikurse bëjnë me Shkrimet e tjera, për përhumbljen e tyre» (2 Pjetrit 3:16). «Të shtrembërosh» shkrimet për të justifikuar opinionet e dikujt është njësoj sikur të thuash: «Në qoftë se kuptimi nuk është ashtu siç e dua unë, atëhere unë do t'u jap kuptimin që dua!» Një shembull mund të jetë 1 Korintasve 1:17. Pali tha: «Sepse Krishti nuk më dërgoi të pagëzoj», dhe ne mund të themi se Bibla mëson se pagëzimi është i parëndësishëm, ndërkaq që Testamenti i Ri na mëson se pagëzimi është i rëndësishëm.*

Në qoftë se Bibla na mëson diçka ndryshe nga çfarë kemi besuar, në vend që të ndryshojmë Shkrimet për të justifikuar bindjet tona, ne duhet të ndryshojmë bindjet tona duke i sjellë ato në harmoni me Shkrimet.

*Disa përdorin metoda të gabuara për të studjuar Biblën. Disa njerëz janë zemërmirë, ata e respektojnë Biblën dhe duan që të mos paragjykojnë. Por ata prapë bëjnë gabime, sepse ata neglizhojnë rregullat elementare dhe të qarta të interpretimit të Biblës. Këtu kemi disa nga këto rregulla:*

1. Vëreni situatën në të cilën gjendet çdo varg. Pyesni, Kush po flet? Kujt po i flet? Kur po flet? Për çfarë qëllimi po flet?

2. Mos shiko vetëm çfarë thotë një varg apo një fragment nga Bibla për një temë të caktuar. Merr në konsideratë atë që *e tërë Bibla* thotë për këtë temë.

3. Përdori pjesët që janë më të thjeshta për t'u

kuptuar për të interpretuar pjesët që janë më të vështira për t'u kuptuar. Kështu nëse një fragment flet për ardhjen e dytë Krishtit, por nuk është shumë e qartë se çfarë thotë, atëherë shko në një varg apo fragment tjetër (apo shumë fragmente të tjerë) që flasin rreth ardhjes së dytë të Krishtit në një mënyrë më të kuptueshme. Pas kësaj, mund ta interpretosh vargun apo fragmentin e parë duke përdorur ato që mësove nga vargu apo fragmenti i dytë.

4. Dallo nëse fragmenti është shkruar me një gjuhë figurative apo me një gjuhë të drejtpërdrejtë.

5. Në fund pyet: «Si mund ta zbatoj unë këtë mësim të Biblës në jetën time?»

Njerëzit i thyejnë këto rregulla. Për shembull, kur ata thonë se Krishti do të kthehet dhe se Ai do të vendosë një mbretëri në tokë mbi të cilën do të mbretërojë për një mijë vjet. Ata e bazojnë interpretimin e tyre në pjesë që kanë kuptim figurativ dhe të paqartë dhe injorojnë pjesët nga Bibla që thonë qartë se mbretëria e Krishtit *nuk* është e kësaj bote (Gjoni 18:36).

*Problemi parësor në keqinterpretimin e Biblës është se disa nuk e duan të vërtetën në mënyrë të mjaftueshme.* Shikoni 2 Thesalonikasve 2:10–12:

... për ata që humbin, sepse nuk pranuan ta duan të vërtetën për të qenë të shpëtuar. E prandaj Perëndia do t'u dërgojë atyre një gënjim që do t'i bëjë të gabojnë, që t'i besojnë gënjeshtërës, që të dënohen të gjithë ata që nuk i besuan të vërtetës, por përqaftuan ligësinë!

Vëreni se kjo thotë: (1) Disa do të dënohen. (2) Ata do të dënohen, sepse besojnë një gënjeshtër. (3) Perëndia do t'u dërgojë atyre një gënjim që t'i besojnë gënjeshtërës, sepse «ata nuk i besuan të vërtetës». Kur dashuria për të vërtetën largohet nga mendja e një njeriu, gënjeshtërja do të zërë boshllëkun e krijuar. Jezusi tha: «Kërkoni dhe do të gjeni»

(Mateu 7:7). Në qoftë se do të kërkojmë pa pushim të njohim të vërtetën, ne do ta gjejmë atë! Problemi është se njerëzit nuk e duan të vërtetën në mënyrë të mjaftueshme, që ta kërkojnë atë pa pushim.

## KONKLUZIONI

Edhe pse mund të ketë arësye të tjera, arësytet e përmendura më lart janë të mjaftueshme për të kuptuar pse njerëzit e interpretojnë Biblën ndryshe.

Pavarësisht nëse e pranoni apo jo këtë përfundim, sigurisht duhet të pranoni se nuk është faji i Perëndisë dhe as i Biblës që njerëzit nuk bien dakord. Faji është yni! Kur ne nuk biem dakord, *unë* mund të jem gabim, *ju* mund të jeni gabim, por Bibla *nuk* është gabim! Ne mund ta kemi anashkaluar të vërtetën, por ajo ekziston, ajo është një dhe gjendet në Bibël.

Meqënëse kaq shumë njerëz e keqinterpretojnë Biblën, si mund të sigurohemi se e interpretojmë në mënyrë të drejtë? Veproni sipas Shkrimeve më të qarta për ta kuptuar. Për shembull, ungjilli përmban fakte, urdhëra dhe pretime. Me qëllim që ungjilli t'ju shpëtojë, besoni faktet themeltare, bindjuni urdhëresave të qarta dhe ndiqni pretime të thjeshta! Në qoftë se nuk jeni kristianë, besoni faktin e parë se Jezusi është Biri i Perëndisë, bindjuni urdhëresave të qarta për t'u penduar dhe pagëzuar (Veprat 2:38) dhe merrni pretime të shtrenjta për dhuratën e Frymës së Shenjtë, faljen e mëkateve dhe shpresën e jetës së përjetshme! A nuk është e thjeshtë kjo?

Pse nuk i vini në zbatim njohuritë që keni marrë nga Bibla duke jetuar sipas vullnetit të Perëndisë.

## SHËNIME

<sup>1</sup> Një parim apo një numër i caktuar parimesh që formojnë nje trup të vetëm mësimesh, mbi të cilat besimtarëve u kërkohet të bazojnë besimin e tyre te Perëndia. Fjala mund të përdoret në fusha të ndryshme si shkencë, politikë etj. Këtu fjala është përdorur në lidhje me kristianizmin dhe kristianët.

Autor: Coy Roper  
Marrë nga studimi: "Pyetje lidhur me besimin te Perëndia"  
© 2001, 2003 E VERTETA PER SOT  
Të gjitha të drejtat të rezervuara